



REPUBLIKA E SHQIPERISE

MARREVESHJE BASHKEPUNIMI

Ndermjet
GJYKATES SE RRETHIT GJYQESORE
TROPOJE

Dhe

INSTITUCIONEVE VENDORE TE RRETHIT TROPOJE
SHTATOR
2015

Duke pare nevojen per bashkepunim dhe mirekuptim mes palesh, ne menyre qe te rritet transparencja, paanshmeria dhe efekshmeria ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesore Tropoje

PALET BIEN DAKORT:

Te lidhin kete marreveshje si me poshte:

Neni I
PARIME TE PERGJITHSHME

1. Kjo marreveshje synon sigurimin e ndihmes nga ana e institucioneve publike shtetërore dhe private te rrethit Tropoje palë në gjykim ne drejtim te rritjes se transparencës ,paanshmerise dhe efektshmerise se gjykimit te çeshtjeve gjyqesore nga ana e Gjykates se Rrethit Gjyqesore Tropoje.
2. Shkembimi i informacionit dhe bashkepunimi do te behet vetem nepermjet menyrave te lejuara nga dispozitat ligjore ne fuqi qe rregullojne kuadrin ligjor te funksionimit te institucioneve perkatese ;
3. Kjo marreveshje sherben si baze bashkepunimi dhe nuk krijon te drejta ose detyrime ligjore. Kjo marreveshje nuk ndryshon ndonje ligj ose akt nenligjor ne fuqi. Gjithashtu nuk ndikon ne ndonje marreveshje tjeter qe institucionet publike

shtetërore dhe private të rrethit Tropoje kanë me institucione të tjera. Përcaktimet e kësaj marrëveshjeje, nuk mund të cenohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej institucioneve, që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, në bazë të të cilit këto institucione janë krijuar dhe funksionojnë.

4. Institucionet publike shtetërore dhe private të rrethit Tropoje palë në procese gjyqësore në bazë të kësaj marrëveshjeje jo vetëm do të përfaqësohen në gjykim, por do të marrin të gjitha masat për të zbatuar urdhërat e vendimet e gjykatës gjatë procedurave gjyqësore.

Neni 2

INSTITUCIONET NENSHKRUESE

Institucionet nënshkruese të kësaj marrëveshjeje janë :Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropoje, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropoje, Bashkia TROPOJE, N/Prefektura Tropoje ,Komisariati i Policisë Tropoje,Institucioni i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Tropoje,Zyra e Sherbimit të Proves Tropoje,Zyra e Permbarimit Tropoje,Zyra Vendore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tropoje,Dega Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tropoje,Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Dega Tropoje ,Zyra Aresimore Tropoje, Zyra e Sherbimit Pyjor Tropoje,Zyra e Sherbimit Postar Tropoje ,Drejtoria e Sherbimit Spitalor Tropoje, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dega Tropoje.Dega e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor Tropoje,Avokatet që ushtrojnë veprimtarinë në Rrethin Tropoje,

Neni 3

QELLIMI I MARRËVESHJES

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është përcaktimi i procedurës dhe vendosja e rregullave të bashkëpunimit dypalësh në mënyrë që të sigurohet:

- a) pjesëmarrja e këtyre institucioneve në gjykim kur janë palë në proces nëpërmjet dergimit të përfaqësuesve të tyre në gjykim.
- b) Zbatimi i urdhrave dhe vendimeve të gjykatës nga ana e këtyre institucioneve konformë dispozitave ligjore në fuqi.

2. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje për bashkëpunim mespalësh, i shërben rritjes së transparencës ,paanshmerisë dhe efektivitetit të gjyqësorit të çështjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropoje.

Neni 4

FORMATI I BASHKËPUNIMIT

1. Ne disa raste nga ana e gjykates eshte konstatuar moskthimi i pergjigjeve nga ana e institucioneve shtetore ose pergjigja nga ana e tyre nuk eshte kthyer ne kohen e duhur ose aktet jane derguar thjeshte fotokopje dhe kjo eshte bere shkas per shtyrjen e seancave.

- Lidhur me kete situatë institucionet publike shtetore dhe private pjesmarrese ne kete marreveshje marrin persiper qe shkresave, urdherimeve apo vendimeve te Gjykates se Rrethit Gjyqesore Tropoje: a) tu kthejne pergjigje brenda afatit te caktuar, b) nese prova apo informacioni nuk munde te merret nga institucioni te cilit ju ka kerkuar, Gjykates ti kthehet pergjigje negative duke e orientuar gjykatën se ne cilin institucion munde te merret informacioni apo prova shkresore, c) prova do te dorezohet ne Gjykate ne original apo e njesuar me origjinalin, d) do te krijojne letesirat e nevojshme ekspertit te caktuar nga gjykata qe te beje verifikimet perkatese prane institucioneve duke i vene ne dispozicion dhe provat.

2. Ne disa raste njoftimi per datën ditën dhe orën e gjykimit per sejcilin prej institucioneve pjesmarrese ne kete marreveshje, lidhur me paraqitjen e dokumentave dhe perfaqesuesve ne gjykim realizohet aktualisht nepermjet sherbimit postare, kjo menyre komunikimi ka sjelle vonesa ne gjykimin e ceshtjeve.

- Lidhur me kete situatë institucionet pjesmarrese ne kete marreveshje marrin persiper qe komunikimi munde te realizohet dhe permes adreses se postes elektronike (e-mail), duke u skanuar njoftimi i gjykates pasi kjo menyre njoftimi eshte ne perputhje me nenin 133/3/4 te K.Pr.Civile.
- Gjykata e Rrethit Gjyqesore Tropoje merr persiper se qe ne shkresen e pare qe i dergon institucionit shtetore per paraqitje prove do te kujdeset duke i bere me dije: a) detyrimin ligjore qe rrjedh nga nenet 223, 224 te K.Pr.Civile, b) pasojen e parashikuar nga nenet 167 dhe 169 te K.Pr.Civile, c) datën deri ne te cilën duhet te paraqitet akti, d) faktin se ka informuar ne te njejten kohe dhe institucionin epror.

3. Ne disa raste ne dosjet hetimore adresat e deshmitareve nuk jane shume te sakta e per pasoje flethirja kthehet e pakonfirmuar, gjithashtu dhe mosparaqitja e deshmitareve te kerkuara nga palet behet shkas per zvarritjen e procesit.

- Lidhur me kete situatë Prokuroria e Rrethit Gjyqesore Tropoje dhe avokatet mbrojtës te paleve marrin persiper qe: a) lista e personave te thirrur si deshmitare te jete e qarte dhe per sejcilin prej tyre te percaktohet adresa e banimit dhe Nr telefoni, kjo me qellim qe nese deshmitari nuk paraqitet ne seancen e pare dhe pse ka marre dijëni rregullisht ku ne vijim Gjykata te urdheroje shoqerimin e detyrueshem permes Komisarariatit te Policise Tropoje, b) kur eshte e mundur Prokuroria e Rrethit Gjyqesore Tropoje dhe avokatet mbrojtës te paleve marrin persiper njoftimin dhe thirrjen e deshmitareve te kerkuar per deshmitaret e kerkuar nga ana e prokurorisë duhet te njoftohen nga vete institucioni permes oficerëve te policies gjyqesore, c) kur eshte e mundur paraqesin pretendimet perfundimtare brenda te se njejtës sëance gjyqesore.

4. Ne disa raste gjykata ka konstatuar vonesa ne kthimin e pergjigjeve lidhur me realizimin e detyrave te lena nga gjykata qe kane te bejne me:a)njoftimin e te pandehurit qe nuk paraqitet,b)njoftimin e deshmitarit,c)shoqerimin e detyrueshem te deshmitarit,d)mosparaqitjen e procesverbalit te njoftimit dhe veprimeve perkatese te ndermarra.

- Lidhur me kete situate Komisariati i Policise Tropoje merr persiper realizimin e detyrave te lena nga gjykata qe kane te bejne me:a)njoftimin e te pandehurit qe nuk paraqitet,b)njoftimin e deshmitarit,c)shoqerimin e detyrueshem te deshmitarit,d)mosparaqitjen e procesverbalit te njoftimit dhe veprimeve perkatese te ndermarra.

Neni 5

SHQYRTIMI I MARREVESHJES

1. Institucionet nenshkruese do te rishikojne vazhdimisht zbatimin e kesaj marreveshjeje dhe do ta konsultojne ate me synimin e permiresimit dhe te zgjidhjes se problemeve te ndryshme qe mund te dalin.

Neni 7

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

1. Ngarkohen institucionet pjesmarrese ne kete marreveshje me strukturat e tyre perkatese per zbatimin e detyrave te parashikuara ne kete Marreveshje Bashkepunimi.

2. Cdo rregullim ose ndryshim sipas nenit 5, ne kete Marreveshje Bashkepunimi, mund te kryhet vetem nepermjet pelqimit reciprok te paleve.

3. Cdo mosmarreveshje ne lidhje me interpretimm dhe zbatimin e kesaj marreveshjeje zgjidhet me mirekuptim midis paleve.

4. Marreveshja e Bashkepunimit mund te perfundoje me njoftimin me shkrim te seciles pale, nje muaj pas ketij njoftimi.

Neni 8

Hyrja Ne Fuqi

Kjo Marreveshje do te jete ne fuqi per nje periudhe kohe te pakufizuar dhe hyn ne fuqi ne daten e nenshkrimit .

1.

Kjo marreveshje hartohet ne 18(tetumbedhjete) kopje dhe secila nga palet mban nje kopje ne original.

Nenshkruar , sot me 14/09.2015, ne Bajram Curri TROPOJE.

Gjykata e Rrethit Gjyqesore TROPOJE Prokuroria e Rrethit Gjyqesore TROPOJE.

KRYETARI
Z. Artan HAIREDDINAT

Drejtuesi i PROKURORISE
Z. Artan SHTRUNGZA

Bashkia TROPOJE
KRYETARI
Z. Besnik DUSHAJ

N/Prefektura TROPOJE .
N/PREFEKT
Z. Mustaf TAHIRAJ

Komisariati i Policise TROPOJE
z.Besim PALAMANI

I.E.V.Penalë TROPOJE
z.Granit KURMEKAJ

Zyra e Sherbimit te Proves TROPOJE.
Z. Sami LAFAJ

D.R.S.Shendetesore TROPOJE
Z. ÇLIRIM HAJDARMAJAJ

Zyra e Perimbarimit TROPOJE.
Z. Eduart MRISHAJ

Z.V.R.Policise TROPOJE.
Z. Ervin KULICI

D.R.S. Shoqerore TROPOJE.
Z. Muje GOSTURANI

O.S.H.E. TROPOJE
Z. Ervin KULICI


Zyra Arsimore TROPOJE
Z. Petrit ZENELI

Zyra e Sherbimit Proves TROPOJE.
Z. Sami LAFAJ

Zyra e Sherbimit Postare TROPOJE.
Z. Andrin QELFIJA

Drejtoria e Shendetit Publik TROPOJE.
Z.Kongres IMERAJ

Drejtoria e Sherbimit Spitalor TROPOJE A.K.Z.M dega TROPOJE
Z. Erjon MULA Z.Blerant LUSHAJ





D.S.K.Shendetesore TROPOJE.
Z. Kongres IMERI

Dega Sherbimit Pyjor TROPOJE
Z. Elez DEMIRI

Avokatet qe ushtrojne veprimtarine ne Rrethin Tropoje

AVOKAT
AV. Rafi MUYA
Nr. Lic. 1744

AV. Besnik DUSHA

AV. Durim SELIMAJ

